

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbështetje për UÇK-në në Bronx, Shkëlqim Hajdari: “Liderët tanë meritojnë drejtësi, jo mëshirë”
ADRESA	https://kohajone.com/kosova/mbeshtetje-per-uck-ne-ne-bronx-shkelqim-hajdari-lideret-tane-meritojne-drejttesi-jo-meshire/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 17:08:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 17:57:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5dbd7c92aa4fc10df469bfce282913ffb439c80dcb59cd3a9a524a861df8b78f
TEKSTI	d879bc28b1ed9c7810f9a723f8dd0da505b33b438edee2a97e3f659164c52211
PAMJA	8a430ff20f45ae63ffa62e3ad959b2a7e5bc1a3c57f1fdb96ad04a4568b45d8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8a1a1c71b52a9ea4978c9f7b61281ab1476a9ff61817cb69a642524000bdc006
E MËPARSHMJA	2d9a31068a0215e9bf708f0ead8bf3855c7c414a642c5808197b57cad603c2bb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8a1a1c71b52a9ea4978c9f7b61281ab1476a9ff61817cb69a642524000bdc006>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Mbështetje për UÇK-në në Bronx, Shkëlqim Hajdari: “Liderët tanë meritojnë drejtësi, jo mëshirë”

[Aktualitet](#) E Shtunë, 12 Shtator 2026 19:57



Një protestë në mbështetje të ish-drejtuesve të UÇK-së, të cilët ndodhen në Hagë, është zhvilluar në Bronx të New York-ut, ku shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare u mblodhën për të shprehur solidaritetin e tyre.

Protesta u organizua nga Shoqata e Veteranëve të UÇK-së, Batalioni i Atlantikut dhe shoqata të tjera patriotike e kulturore shqiptare në New York, me pjesëmarrjen e shqiptarëve nga Kosova dhe trevat shqiptare.

 [Koha YouTube Channel](#)

Në aktivitet ishte i pranishëm edhe Prefekti i Qarkut të Tiranës, Shkëlqim Hajdari, i cili përcolli përshëndetjet e Tiranës për shqiptarët e mbledhur në Bronx.

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

Në fjalën e tij, Hajdari tha se shqiptarët kanë vijuar të kërkojnë drejtësi për ish-drejtuesit e UÇK-së përmes protestave të zhvilluara në Prishtinë, Hagë, Tiranë, Shkup, qytete të ndryshme të Evropës dhe në diasporë.

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Ai solli në vëmendje edhe protestën e zhvilluar më 17 tetor 2025 në Tiranë, ku mijëra shqiptarë u mblodhën në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

“Mesazhi është i njëjtë: drejtësi për çlirimtarët”, u shpreh Hajdari.

Duke folur për luftën e UÇK-së, ai tha se ajo lindi nga dhimbja e popullit të Kosovës dhe luftoi për lirinë dhe mbrojtjen e tij.

“UÇK-ja lindi nga dhimbja e një populli dhe luftoi për mbrojtjen e ekzistencës dhe lirinë e tij. Nuk luftoi në tokën e askujt tjetër. Luftoi në tokën e vet, për popullin e vet dhe për të drejtën e tij për të jetuar i lirë”, tha Hajdari.

Ai theksoi se shqiptarët nuk kërkojnë mëshirë apo privilegje, por drejtësi.

“Kërkojmë drejtësi!”, deklaroi ai, duke shprehur besimin te drejtësia ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbështetja që, sipas tij, SHBA-ja i ka dhënë Kosovës gjatë periudhave më të vështira.

Hajdari kujtoi gjithashtu rolin e Shteteve të Bashkuara gjatë luftës në Kosovë dhe vlerësoi miqësinë mes shqiptarëve dhe SHBA-së.

Në përfundim të fjalës së tij, ai u shpreh se shqiptarët presin pafajësinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, si dhe kthimin e tyre pranë familjeve dhe popullit të Kosovës.

“Zoti e bekoftë Kosovën, Shqipërinë dhe gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Zoti e bekoftë UÇK-në, luftëtarët, dëshmorët dhe veteranët e saj. Zoti e bekoftë miqësinë e përhjetshme të shqiptarëve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, përfundoi Hajdari.

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)

 Logo KOHA JONË SONDAZH

A duhet liruar Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?


☐ Po

☐ Jo

Voto

Shiko rezultatin

[Më shumë nga Aktualiteti](#)



[Kadastra zbarkon në Piqeras, nis verifikimi i regjistrimeve](#)



[Pritën Ramën pas takimit në Vlorë, policia shoqëron Baki Goxhaj dhe ...](#)



[Përplasen dy automjete në Shupenzë, dy persona të plagosur](#)



[Nafta “fluturon” në çmim, litri shkon në 229 lekë](#)



[28 vite nga humbja e Azem Hajdarit, Berisha e përkujton me thirrje për...](#)



[Reshjet e dendura pushtojnë Elbasanin, Bashkia në gatishmëri për çdo ...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)



[Spektakël golash në Romë, Moreira ndal Lazion, Milani merr një pikë](#)

31 minuta më parë



[Mbështetje për UÇK-në në Bronx, Shkëlqim Hajdari: “Liderët tanë meritojnë drejtësi, jo mëshirë”](#)

40 minuta më parë



[Akuzat e reja ndaj ish-zv.kryeministres, Rama: “Aty as unë dhe askush tjetër nuk e mbron, aty ajo mbron veten e vet”](#)

53 minuta më parë





“Njësitë administrative nuk funksionojnë”, Rama paralajmëron ndryshime në Reformën Territoriale

1 orë e 37 minuta më parë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.